

LIGJ
Nr.7598, datë 1.9.1992

PËR KRIJIMIN E FONDIT TË VEÇANTE MONETAR PËR ISH-TË DËNUARIT E TË PËRNDJEKURIT POLITIKË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Të krijohet fondi i veçantë monetar për të ndihmuar ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë në plotësimin e kërkesave të tyre me karakter urgjent. Ky fond përbëhet nga:

- a) shuma që caktohet çdo vit si zë i veçantë në buxhetin e shtetit.
- b) shuma prej një për qind mbi fondin e pagave, që do të derdhin ndërmarrjet shtetërore jobuxhetore.
- c) vlefte e një pjese të ndihmave humanitare për popullin shqiptar, që do të përcaktohen për çdo rast nga Këshilli i Ministrave.
- ç) vlefte e ndihmave humanitare që japin institucionet bamirëse dhe personat fizikë e juridikë, shqiptarë ose të huaj, të caktuar për isht- të dënuarit e të përndjekurit politikë.

Neni 2

Administrimi dhe drejtimet e përdorimit të këtij fondi do të bëhen nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe e të Përndjekurve Politikë.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë

Shpallur me dekretin nr.290. datë 4.9.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.